

## NË EMËR TË POPULLIT

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Penal**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Minir Hoti, dhe sekretaren juridike Fatmire Podvorica, në çështjen penale kundër të pandehurit F. A. K. nga fshati G., Komuna e P., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, sipas propozim akuzës së Prokurorisë Publike Komunale në Prishtinë PP.nr.7097-7/2011 të dt.27.02.2012, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor publik, në praninë e Prokurorit të shtetit Bukurie Gjonbalaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, të dëmtuarit S. M. dhe të pandehurit F. K., pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor gjykata më dt.06.11.2014, të njëjtën ditë mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

I pandehuri: **F. K.**, nga i ati A. dhe e ëma E. e vajzërisë Q., i lindur më dt.*data e lindjes...* në fshatin G., Komuna e P., ku edhe tani jeton, i martuar, baba i katër fëmijëve, i pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, Shqiptarë-Shtetas i Republikës së Kosovës, **gjendet në paraburgim nga data 06.11.2014 e tutje.**

### Ë S H T Ë F A J T O R

#### Sepse:

Me qëllim që me përvetësimin e sendeve të huaja të luajtshme vetit t'i sjell përfitim pasurorë të kundërligjshëm, më dt.30.05.2011, rreth orës 19:00 në fshatin Dobratin, i pandehuri nga livadhet pronë e të dëmtuarit S. M., ka marrë katër viça meshkuj, peshë e secilit prej tyre ka qenë rreth 200 kg, tre prej tyre të racës Simentale, vlera e tyre sillet rreth 500 euro secili, me ç'rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm rreth 2000 Euro,-

-Me këtë ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Andaj gjykata në kuptim të neneve 6, 11, 34, 38, 64 dhe 73 të KPK-së, si dhe në bazë të nenit 365 të KPPRK-së, e :

### G J Y K O N

**I.** Të akuzuarit **F. K.**, i shqipton dënim me burgim në kohëzgjatje prej **2(dy) vjet e 6 (gjashtë) muaj**, të cilin dënim do ta mbaj pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**II.** Pas shpalljes së aktgjykimit të akuzuarit në kuptim të nenit 367 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.3 dhe par.7 të KPPRK-së, i caktohet masa e paraburgimit prej datës

**06.11.2014** deri në plotfuqishmëri të aktgjykimit por jo më shumë se koha e dënimit të shqiptuar në aktgjykim.

**III.** Konform nenit 73 par.1 të KPK-së, në dënimin e shqiptuar i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim nga data **06.11.2014 e tutje.**

**IV.** Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj shumën sipas llogarisë përfundimtare të kësaj gjykate, kurse në emër të paushallit gjyqësor shumën prej **150 Euro** (njëqindpesëdhjetë euro), në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

**V.** I dëmtuari S. M. nga P. Lagja e K., për realizimin e kërkesës pasurore-juridike udhëzohet në kontestin e rregullt juridiko-civil.

### **A r s y e t i m**

Prokuroria Publike Komunale në Prishtinë me propozim akuzën PP.nr.7097-7/2011 të dt.27.02.2012, ka akuzuar të pandehurin F. K. nga fsh. G., KK P., për shkak se ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së.

Lidhur me këtë çështje penale gjykata mbajti seancën e shqyrtimit gjyqësor më dt.17.10.2014 – 03.11.2014 dhe 06.11.2014 në të cilën u dëgjuan Prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj nga Prokuroria Themelore në Prishtinë, i dëmtuari-dëshmitari S. M., dëshmitari B. B. dhe i pandehuri F. K..

Prokurori i shtetit Bukurije Gjonbalaj, gjatë shqyrtimit gjyqësorë dhe në fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet në tërësi pranë propozim akuzës të ngritur kundër të akuzuarit F. K. PP.nr.7097-7/2011 e dt.27.02.2012, në drejtim të veprës penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, sepse nga provat e siguruar në procedurën hetimore dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë në mënyrë të plotë është vërtetuar gjendja faktike në bazë të së cilës qartë dhe bindshëm u vërtetua se i akuzuari F. K. ka kryer veprën penale të përshkruar në dispozitiv të propozim akuzës. Kjo u vërtetua bindshëm nga deklarimi i dëshmitarit B.B. deklarata e tij e dhënë sot në shqyrtim gjyqësorë është identike me deklaratën e dhënë në polici më datën 23.08.2011, i cili qartë dhe bindshëm e ka identifikuar se ditën kritike personi i cili ka qenë duke ju prirë viçave është i akuzuari F. K.. Mbrojtjen e të akuzuarit gjykata duhet ta marr si të pabazuar sepse e njëjta është në kundërshtim me provat e administruara dhe këtë i akuzuari e bën me qëllim të ikjes nga përgjegjësia penale , pasi që duke i analizuar të gjitha provat në përgjithësi rezulton se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar , me çka vërtetohet dyshimi i bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale Vjedhje nga neni 252 par.1 të KPK-së, andaj i propozoj gjykatës që të njëjtin ta shpallë fajtorë dhe ta dënoi sipas ligjit, me rastin e vendosjes për dënimin të ketë parasysh të gjitha rrethanat e parapara me ligj , e si rrethanë rënduese të merret rrezikshmëria shoqërore e veprës e cila është bërë dukuri posaçërisht në rajonin e Podujevës.

I dëmtuari-dëshmitari S. M. në shqyrtimin gjyqësor në dëshminë e tij të dhënë në cilësinë e dëshmitarit deklaroi se kanë qenë katër viça, ngjyrë të kuqe në vlerë prej 2000€uro. Pas një muaj e gjysmë pasi që i kam blerë të njëjtit më janë vjedhur por data nuk më kujtohet, mirëpo kur më kanë humbur viçat unë për 2-3 ditë i kamë kërkuar nëpër bjeshkë, i kam lajmëruar policinë pasi nuk i gjeta viçat, unë edhe pas kësaj kohe i kam kërkuar se kah kanë shkuar. Pas një kohe kamë dëgjuar se B. B. iu kishte marrë një lopë dhe shkova te ai sepse ai kishte parë dikën duke kaluar me katër viça afër shtëpisë së tij, sepse ai kishte qenë në arën e tij duke punuar, kur njëri prej atyre që u grahte viçave ia kishte kërkuar një cigare. Viçat kanë qenë duke kullotur në pronën e K. B. mikut tim pa çoban në kohën kur janë vjedhur. Fillimisht nuk kamë dyshuar në askënd, mirëpo pas bisedës me B. B. kamë filluar të dyshoj në bazë të rrëfimit dhe përshkrimit të tij në F. K., të cilin më herët nuk e kamë njohur.

Ndërsa lidhur me kërkesën pasurore juridike ka deklaruar se për dëmin e shkaktuar paraqet kërkesë në vlerë prej 2000 euro, aq sa ka qenë dëmi i shkaktuar.

Dëshmitari B. B. në shqyrtimin gjyqësor në dëshminë e tij deklaroi se më kujtohet mirë që ja kanë vjedhur një personi 4 viça. Atë ditë kam qenë në arë duke prashitur pasul pasdite në arën time të "Guri", edhe janë ardhur afër arës e cila është e thurur me tel, një djalë u ardhur më para dhe më ka thënë "A po ta don" edhe a je lodhur hiq, unë i thashë me ma dashtë spo ma donë hiq, e me u lodhur jo, në ato fjalë kanë dalur edhe dy djem tjerë me 4 viça, të cilët ishin duke ju grahur, ndërsa ky që foli me mua ishte duke ju prirë atyre, ky personi që ju prike atyre mu ka afruar shumë afër dhe kemi biseduar me të dhe me tha a e pinë duhanin edhe me tha se a ma jep një cigare, unë i thash po, po i kam cigaret të liga. Pastaj unë e pyeta se ku i morët këto "gja" a kah po i qoni, me tha se me kanë ikur nga fshati Buricë, na i ka marur xekri edhe kanë shkuar në fshatin Bradash, dhe atje i kem zënë dhe po i biem kësajde, se ma fllad dhe po i dërgojmë në shtëpi. Përpara nuk e kam njohur dhe nuk e kam para me asnjëherë. Sot nuk e dijë a e njoh apo se njoh se i kam bërë edhe sytë operacion, dhe nuk shohë mirë, sepse unë kur e kam dhënë deklaratën e kam identifikuar me fotografi të cilën ma kanë qitur përpara, dhe kam qenë shumë i sigurt në fotografinë të cilat mi ka qitur ajo çika-policja, të cilat fotografi mi ka qitur rend dhe unë e kam njohur dhe jam ndalur te ajo fotografi dhe i kam treguar se është ky personi i cili ju ka prirë atyre 4 viçave dhe ka biseduar me mua. Sot i sigurt nuk jam por ka qenë sikur ky por e ka pasur një kaqket me strehë deri të hunda, dhe e ka pasur një dhëmb të thyer në pjesën e parë unë kam ardhur këtu me tregua për atë që kam parë, për të cilën kam treguar edhe në polici. Viçat kanë qenë ngjyrë të kuqe me të bardhë dhe 3 kanë qenë të mëdhenj dhe një më i vogël.

I akuzuari F. K. në mbrojtjen e tij të dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare e ka mohuar kryerjen e veprës penale dhe ka shtuar se gjatë shqyrtimit gjyqësor do të vërtetohet se unë nuk e kam kryer këtë vepër, kurse më vjen keq që i ka ndodhur ky rast të dëmtuarit.

Pas administrimit të provave, vlerësimit dhe krahasimit të tyre, gjykata në mbështetje të nenit 8 dhe 361 të KPPRK-së, vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Gjendjen e tillë faktike si në dispozitiv të aktgjykimit gjykata e vërtetoi nga këto prova: nga dëshmia e të dëmtuarit S. M. e dhënë në cilësinë e dëshmitarit në shqyrtimin gjyqësor, nga dëshmia e dëshmitarit B. B. e dhënë gjatë shqyrtimit gjyqësor, si dhe nga provat tjera materiale që gjenden në shkresat e lëndës siç janë deklaratat e të dëmtuarit S.M. e dhënë në Stacionin Policor në Podujevë më 02.06.2011, Deklarata e dëshmitarit B. B. e dhënë në Stacionin Policor në Podujevë më 23.08.2011, si dhe nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës.

Nga dëshmia e të dëmtuarit-dëshmitarit S. M. gjykata vërtetoi se më dt.30.05.2011, rreth orës 19:00, në livadhet në fshatin D., KK Podujevë, i janë vjedhur 4 viçat të racës simentale, ngjyrë kuq dhe bardh, të moshës 10 muajsh, me çka me këtë rast i është shkaktuar dëm i konsiderueshëm material diku në vlerë rreth 2000€uro.

Nga dëshmia e dëshmitarit B. B., vërtetohet fakti se i akuzuari F. K. më datën 30.05.2011 në orët e pasdites ishte parë nga dëshmitari B. B. duke ju prirë 4 viçave, ngjyrë të kuqe me të bardhë, duke i dërguar në drejtim të fshatit Buricë.

Nga foto dokumentacioni që gjendet në shkresat të lëndës vërtetohet fakti se dëshmitari B. B. në Stacionin Policor në Podujevë ka bërë identifikimin e personit që u kishte prirë viçave në bazë të fotografisë së të akuzuarit F. K. e cila i është paraqitë në mesin e shumë fotografive të të dyshuarve të tjerë.

Andaj, duke u mbështetur në këto fakte dhe provat e administruara gjykata gjeti se në veprimet e të akuzuarit F. K. formohen të gjitha elementet qenësore të veprës penale Vjedhje nga 252 par.1 të KPK-së.

Gjykata ia fali besimin deklaratës së të dëmtuarit-dëshmitarit S. M., pasi që deklaratat e tij përputhet në tërësi edhe me deklaratën e dëshmitarit B. B. të dhënë në Stacionin Policor në Podujevë por edhe me vetë deklarin e tij në shqyrtim gjyqësorë.

Gjykata ia fali besimin deklaratës së dëshmitarit B. B. ngase deklaratat e tij e dhënë në polici përputhet me deklaratën e dhënë në shqyrtim gjyqësorë, me të cilën në mënyrë bindëse ka bërë identifikimin e të akuzuarit F. K., deklaratat e tij përputhet edhe me gjendjen faktike se personi që ju ka prirë 4 viçave kishte një dhëmb të prishur në pjesën e parme të gojës, ndërsa në mënyrë të qartë ka paraqitë edhe bisedën që kishte zhvilluar në momentin kur i akuzuari F. K. i kishte kërkuar një cigare derisa ky ishte duke punuar në arën e tij.

Sipas vlerësimit të gjykatës mbrojtja e të akuzuarit F. K. është e orientuar kah ikja ndaj përgjegjësisë penale duke e mohuar kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, andaj gjykata nuk ia fali besimin deklarin e tij se ai nuk është kryes i veprës për të cilën akuzohet, sepse ky deklarim nuk ka mbështetje në asnjë provë të vetme, për këtë gjykata gjeti se i akuzuari është përgjegjës për veprimet penale për të cilën është shpallur fajtor.

Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënimin gjykata i vlerësoi të gjitha rrethanat të cilat konform nenit 64 të KPK-së, ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit ashtu që si rrethanë lehtësuese mori gjendjen e tij të dobët ekonomiko-sociale, ndërsa si rrethanë

rënduese mori se i akuzuari edhe më parë ka qenë i dënuar për veprë penale Grabitje, është recidivist, sjelljen e tij pas kryerjes së veprës penale, motivin për kryerjen e veprës, shkallën e rrezikimit apo dëmtimit të së mirës së mbrojtur, andaj të njëjtin e gjykoj si në dispozitiv të aktgjykimit me bindje se dënimi i shqiptuar është adekuat me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të veprës penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë të të akuzuarit, dhe se me këtë dënim do të bëhet risocializimi i tij dhe se do të jetë si preventivë për të dhe të tjerët të mos kryejnë vepra penale të tilla apo të ngjashme, e që është qëllimi i dënimit nga neni 34 i KPK-së.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarit për realizimin e kërkesës pasurore-juridike në kontest civil është marrë në kuptim të nenit 463 par.1 dhe 2 të KPPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor u muar në bazë të nenit 450 par.1 dhe 2 pika 2.1 dhe 2.6 lidhur me nenin 453 par.1 të KPPRK-së.

Vendimi që të akuzuarit pas shpalljes së aktgjykimit t'i caktohet paraburgimi u mor konform nenit 367 par.1 nën par.1.1 lidhur me par.3 dhe par.7 të KPPRK-së.

Vendimi që të akuzuarit në dënimin e shqiptuar ti llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim u mor në kuptim të dispozitave të nenit 73 par.1 të KPK-së.

Nga sa u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË-DEGA PODUJEVË**  
**P.nr.212/2012 më dt.06.11.2014**

**Sekretarja juridike:**  
Fatmire Podvorica

**Gjyqtari :**  
Minir Hoti

**KËSHILLA JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet Ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimin të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmes kësaj gjykate.